



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:027012  
Datë: 18.03.2024  
Numri i dokumentit: 05465276

**C.A.P.nr.1571/23**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, nga Gjykatësi Individual Besnik Feka, në lëndën përbarimore të kreditorit B. F. nga P, të cilën me autorizim e përfaqëson avokat D. R. nga P, kundër debitorit S. G. nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat H. P. nga Prishtina, për shkak të borxhit sipas dokumentit përbarimor vlera **31, 582 euro**, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.1956/19 i datës 10.03.2021, me datë **18.03.2024**, nxjerr këtë:

### A K T V E N D I M

**I.REFUZOHET SI E PA BAZUAR**, ankesa e debitorit S. G. nga P., ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PPP.nr.1956/19, i datës 10.03.2021, **VËRTETOHET**.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.1956/19, i datës 10.03.2021, ka vendosur si në vijim:

**I.REFUZOHET** si i pa bazuar prapësimi i debitorit S. G. nga P., ushtruar kundër Urdhërit të Përbaruesit Privat P.nr.I.br:701/19, i datës 21.08.2019, dhe është lënë në fuqi i njëjti urdhër, si dhe njëkohësisht është detyruar debitori që kreditorit, në emër të shpenzimeve të procedurës t’ia paguaj shumën totale prej 312 euro.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori S. G. nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPP-së dhe LPK-së, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke e kundërshtuar në tërësi aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e debitorit si e bazuar; të anulohet aktvendimi i kundërshtuar dhe çështja kthehet në rishqyrtim.

Përgjigje në ankesën e debitorit, nuk është ushtruar nga kreditori.

Gjykatësi Individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, si dhe pretendimet ankimore, dhe në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, 17 dhe 77 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209, pika d) të LPK-së, gjeti se:

**-Ankesa e debitorit S.G., rezulton e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori B. F. nga Prishtina, përmes të autorizuarit të tij, avokat Destan Rukiqi nga Prishtina, me datën 21.08.2019, pranë organit përbarues-Përbaruesit Privat "METAJ LAW" me seli në Prishtinë, ka ushtruar propozim për përbarim në bazë të dokumentit përbarimor dhe atë Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.559/2009, i datës 16.12.2014, i plotfuqishëm që nga data 11.06.2019, dhe i përbarueshëm që nga data 13.08.2019, me të cilin në pikën I të dispozitivit të dokumentit përbarimor është detyruar këtu debitori S. G. nga P., që kreditores B.F. nga Prishtina në emër të kompensimit të pasurisë së veçantë-shtëpisë së ndërtuar nga babai i saj si dhuratë për të bijën për martesë, t'ia paguaj shumën prej 31,582 euro, me kamatë ligjore në lartësi siç e paguajnë bankat afariste për mjetet e afatizuara për një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 16.12.2014 e gjer në përmbushjen definitive të detyrimit, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,429 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.

Përbaruesi Privat, me Urdhërin për Lejimin e Përbarimit, P.nr.I.br:701/19, i datës 21.08.2019, ka lejuar përbarimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori, S. G. nga P., brenda afatit ligjor ka ushtruar kundërshtim me shkrim kundër Urdhërit për Lejimin e Përbarimit, me të cilin në tërësi e ka kundërshtuar propozimin për përbarim të kreditorit dhe urdhërin për lejimin e përbarimit, me arsyetimin se shumica e kërkuar si në propozim për përbarim nuk përkon fare me realitetin objektiv, dhe se debitori kujdeset vet personalisht për tre fëmijët e vegjël e sidomos për fëmijun e përbashkërt Dineta Gashi e cila i është besuar këtu debitorit, e gjithashtu, gjatë ndërtimit të shtëpisë nga e cila kreditorit i është njohur kompensimi sipas dokumentit përbarimor, shumën prej 17,000 euro, ia ka keqpërdor babai i kreditorës njëherit vjehri i debitorit, ashtu që, duke keqpërdor edhe patundshmëri tjera debitori është keqpërdor nga kreditori dhe babai i saj në shumën e tërësishme prej 28,300 euro, dhe mbi bazën e këtyre arsyeve, i ka propozuar gjykatës së shkallës së parë që e njëjta ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe ta lë jashtë fuqie Urdhërin për Lejimin e Përbarimit e njëkohësisht ta refuzoj propozimin për përbarim.

Kreditorja B. F., përmes të autorizuarit saj avokat Destan Rukiqi nga Prishtina, brenda afatit ligjor prej 3 ditësh, ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të ushtruar në prapësim, me propozim për gjykatën që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit dhe urdhëri për lejimin e përbarimit të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë si organ përbarues, duke vepruar sipas prapësimin të debitorit, pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim dhe shkresave të lëndës, nxjerr aktvendimin e ankimuar,

duke e refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe duke e lënë në fuqi aktvendimin për lejimin e përmbarimit, me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të tij.

Gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e dhënë lidhur me mënyrën e vendosjes ka theksuar se gjykata e refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar ngase të njëjtat pretendime bien ndesh te hapur me dokumentin përmbarimor përkatësisht me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.559/2009, i datës 16.12.2014, i plotfuqishëm që nga data 11.06.2019, dhe i përmbarueshëm që nga data 13.08.2019, me të cilin në pikën I të dispozitivit të dokumentit përmbarimor është detyruar këtu debitori S. G. nga Prishtina, që kreditores B.F. nga P. në emër të kompensimit të pasurisë së veçantë-shtëpisë së ndërtuar nga babai i saj si dhuratë për të bijën për martesë, t'ia paguaj shumën prej 31,582 euro, me kamatë ligjore në lartësi siç e paguajnë bankat afariste për mjetet e afatizuara për një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 16.12.2014 e gjer në përmbarim definitiv të detyrimit, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,429 eur, dhe mbi bazën e nenin 22 par 1, nënpar.1.1 në lidhje me nenin 24 të Ligjit për Procedurë Përmbarimore janë plotësuar kushtet ligjore për përmbarimin e dokumentit përmbarimor, prandaj, edhe mbi bazën e nenit 69 par.4 të LPP-së, në lidhje me nenin 73 par.3 të LPP-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ndërsa për shpenzimet përmbarimore ka vendosur në bazë të nenit 13 par.4 të LPP-së..

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së e konsideron si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjithashtu, aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i shoqëruar as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n) të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht si dhe e drejta materiale është zbatuar drejt.

Nga ekzaminimi i aktvendimit të goditur me ankesë, konstatohet se kreditori B. F. nga Prishtina ka iniciuar procedurë përmbarimore kundër debitorit ish bashkëshortit të saj këtu debitorit S.G. nga Prishtina, dhe atë në bazë të dokumentit përmbarimor Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.559/2009, i datës 16.12.2014, i plotfuqishëm që nga data 11.06.2019, dhe i përmbarueshëm që nga data 13.08.2019, me të cilin në pikën I të dispozitivit të dokumentit përmbarimor është detyruar këtu debitori S. G. nga Prishtina, që kreditores B. F. nga P në emër të kompensimit të pasurisë së veçantë-shtëpisë së ndërtuar nga babai i saj si dhuratë për të bijën për martesë, t'ia paguaj shumën prej 31,582 euro, me kamatë ligjore në lartësi siç e paguajnë bankat afariste për mjetet e afatizuara për një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 16.12.2014 e gjer në përmbarim definitiv të detyrimit, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1,429 euro, dhe në rastin konkret, siç shihet nga dokumenti përmbarimor i njëjti është i plotfuqishëm dhe i përmbarueshëm në pikën I të dispozitivit të tij, kështu që, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe plotësisht ka vepruar kur ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka vërtetuar urdhërin për lejimin e përmbarimit, për faktin se në rastin konkret janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 22 dhe 24 i LPP-së që të fillohet procedura përmbarimore mbi bazën e këtij dokumenti dhe se në bazë të nenit 27 par.1 të LPP-së, dokumenti përmbarimor i lartcekur në pikën I të dispozitivit të tij në të cilën është kërkuar dhe lejuar përmbarimi është i përshtatshëm për përmbarim, prandaj, pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës rezultojnë të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara, për faktin se në bazë të

nenit 69 par.4 të LPP-së, asnjëri nga faktet e pretenduara si në prapësim ashtu edhe në ankesë nuk janë vërtetuar me prova përkatëse, ndërsa detyrimet e debitorit për kujdes ndaj fëmijëve të mitur, janë detyrime ligjore dhe realizimi eventual i detyrimeve të pa përmbushura të kreditores mund të kërkohej në një procedurë tjetër nga debitori, megjithatë në këtë çështje përmbartimore dokumenti përmbartimor i plotëson kushtet për përmbartim dhe është i përshtatshëm për përmbartim.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me shpenzimet e procedurës përmbartimore është në harmoni me nenin 13 par.4 të LPP-së, dhe se këto shpenzime duhet ti bartë debitori.

Gjykata, vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të përfaqësuesit të debitorit, mirëpo, meqë të njëjtat nuk ishin me ndikim në vendim marrje ndryshe, të njëjtat i refuzoi dhe nuk i shqyrtoi në hollësi.

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e të lartcekurave, e në mbështetje të nenit 17, 77 të LPP-së, në lidhje me nenin 194, 208, 209 pikat b) të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**C.A.P.nr.1571/23, me datë 18.03.2024**

**Gjyqtari Individual**  
**Besnik Feka**